

Instituti për Studime të Avancuara GAP

# Junik – Raporti komunal

Tetor 2009

## Juniku në shifra

Popullsia	Gjithsej	9,600
	Shqiptarë	99%
	Të tjerë	1%
Gjeografia	Sipërfaqja në km/2	77.7
	Nr. i fshatrave	2
Shkollimi	Nr. i nxënësve	1,380
	Nr. i mësimdhënësve	66
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	1
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	2
	Nr. i çerdheve	0
	Hapësira shkollore në m <sup>2</sup>	-
Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare	1
	Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore	0
	Nr. i mjekëve	5
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	5,856
	Të punësuar në sektorin publik komunal	141
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	874,276
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	35,000
	Të hyrat tjera (Euro)	839,276
Shpenzimet e realizuara (2008) <sup>1</sup>	Gjithsej (Euro)	644,903 (82%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	144,155 (65%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	500,748 (89%)
Kryetarët e Komunës	2007-2009: Tahir Isufaj	

<sup>1</sup> Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

## Shkurt për Junikun

Juniku është një nga komunat më të reja të Kosovës. Deri në vitin 2005, Juniku ishte pjesë e territorit të Deçanit. Si komunë në vete Juniku është themeluar në bazë të Urdhëresës Administrative 2005/11. Neni 2 i kësaj urdhërese kërkon themelimin e pesë njësive pilote të komunave brenda komunave pjesë e të cilave kanë qenë. Kësisoj, në bazë të kësaj urdhërese u formua komuna e Junikut, Parteshit, Hanit të Elezit, Mamushës dhe Graçanicës. Sot, Juniku përfshinë një territor prej 77.7 km<sup>2</sup> dhe ka një popullatë prej afër 10,000 banorëve. Në aspektin ekonomik, kjo komunë ka qenë kryesisht e orientuar në bujqësi. Këtë ia ka mundësuar lumi Erenik që është një nga pasuritë e kësaj komune. Juniku njihet edhe për pasuri të tjera me karakter turistik, e sidomos me majën më të lartë në Kosovë, Majën e Gjeravicës. Meqenëse Juniku është një komunë e re, ku madje akoma nuk janë mbajtur zgjedhje lokale, mungojnë edhe shumë të dhëna krahasuese për këtë komunë. Juniku është certifikuar si komunë më 13 gusht 2008. Kjo datë tani konsiderohet si festë zyrtare e komunës. Zgjedhjet e Nëntorit 2009 do të shënohen në historinë e kësaj komune të re si zgjedhjet e para lokale të mbajtura ndonjëherë.

## Problemet aktuale

Komunat e reja të Kosovës kanë një gjë të përbashkët sa i përket problemeve me të cilat ballafaqohen qytetarët e tyre. Vetë fakti se këto treva janë bërë komuna në vete, konsiderohet si një e arritur e madhe nga banorët e këtyre komunave. Prandaj, krahasuar me gjendjen e para formimit të komunës, qytetarët ndihen të kënaqur me investimet e bëra, që do të thotë se ata në përgjithësi nuk ankohen për problemet në komunën e tyre. Megjithatë, komuna e Junikut ka disa probleme që kërkojnë angazhim më të madh të komunarëve, sikurse shkatërrimi i pyjeve apo investimet e nevojshme në sistemin e ujitjes. Ndër problemet më madhore të kësaj komune janë:

- Prerja e pyjeve
- Mungesa e sistemit të ujitjes
- Mos zhvillimi i turizmit
- Mungesa e shtëpisë së kulturës
- Mos pastrimi i vendeve të minuara

Komuna e Junikut ka një kapacitet të madh të pyjeve, por **prerja e pyjeve** është një fenomen shqetësues për junikasit. Pyjet jo vetëm që janë një pasuri e kësaj komune, por edhe një atraksion i rrallë turistik. Por, që nga pas lufta e vitit 1999, pyjet kanë filluar të prehen pa kontroll. Në fakt, sa janë dëmtuar pyjet tash, nuk janë dëmtuar as gjatë kohës së okupimit, shprehën bashkëbiseduesit. Problemi qëndron në faktin se pyjet i janë dhënë për ruajtje autoriteteve nga Deçani, e jo atyre të Junikut. Kurse edhe më shqetësuese është fakti se pyjet po prehen nga qytetarët e Deçanit. Edhe pse në fakt në rrugën që bie poshtë pyllit ekzistojnë rojet që bëjnë mbikëqyrjen e pyllit, junikasit shprehin rezerva mbi efikasitetin e punës së tyre. Përfundimisht, banorët e Junikut kërkojnë nga komuna që të marrë nën mbikëqyrje sigurimin e pyllit.

**Mungesa e sistemit të ujitjes.** Shumica e banorëve të Junikut të ardhurat e tyre i sigurojnë nga bujqësia. Juniku është ndër komunat e rralla që ka një sasi të madhe të ujit, i cili vjen nga lumi i Erenikut. Ky lum është i pashtershëm gjatë gjithë kohës. Me gjithë këtë sasi të madhe të ujit, Junikut i mungon një sistem i mirëfilltë ujitës. Deri

më tani ka ekzistuar një pendë e vjetër, por nuk ka kanale që do ta dërgonin ujin në çdo pjesë të tokave bujqësore. Banorët e kësaj komune thonë se nuk është e drejtë që banorët e komunave tjera ta shfrytëzojnë ujin e lumit Erenik për ujitje, kurse Junikasit, prej nga buron ky lum, nuk arrijë ta shfrytëzojnë atë siç duhet. Problem tjetër që është në dukje kohëve të fundit është edhe mos mirëmbajtja e lumit. Është bërë shprehi e qytetarëve që t'i hedhin mbeturinat në lum, dhe kjo si pasojë e mungesës së efikasitetit të kompanisë së higjienës. Lumi Erenik ende nuk e ka shtratin e rregulluar.

Përkundër posedimit të kapaciteteve për tërheqjen e turistëve, nuk është bërë mjaft për **zhvillimin e turizmit** në Junik. Komuna e Junikut në Kosovë njihet edhe për pikën më të lartë mbidetare që ka, majën e Gjeravicës me lartësi mbidetare prej 2654 metra. Por, edhe përkundër pamjes piktoreske që ofron kjo pikë malore, nuk është bërë shumë në tërheqje e vizitorëve. Rruga që qon drejt kësaj pike asnjëherë nuk është marrë seriozisht nga komuna për tu përmirësuar dhe për tu bërë më e kalueshme për vizitorët. Vlen të cekët se përveç pikës më të lartë në Kosovë, Juniku ka edhe atraksione të tjera turistike sikurse dy liqenet natyral të Gjeravicës, si dhe pjesët e freskëta malore pranë lumit Erenik.

**Mungesa e shtëpisë së kulturës.** Edhe përkundër investimeve që janë bërë gjatë tri viteve të fundit, Komunës së Junikut i mungon Shtëpia e Kulturës ku do të mbaheshin aktivitete kulturore si dhe tubime të tjera të qytetarëve. Kësaj komune po ashtu i mungon një sallë e sportit për zhvillimin e aktiviteteve sportive të rinjve junikas. Kur jemi te sallat e sportit, vlen të cekët se edhe dy shkollat, ajo fillore dhe e mesme, nuk kanë sallë sporti për nevojat e nxënësve.

Edhe pse shumica e vendeve të minuara në Kosovë tashmë janë pastruar nga minat, në pjesët rurale të Junikut, banorët ende ndiejnë **rrezik nga minat**. Komuna e Junikut është ndër vendet e pakta në Kosovë që akoma nuk e ka të pastruar territorin e vet nga minat e lëna nga ushtria serbe. Edhe pse nuk flitet për ndonjë fatkeqësi të ketë ndodhur nga shpërthimi i minave, qytetarët ankohen se ka disa territore që dyshohet se ende ka mina aty. Rreziku nga minat është edhe një ndër shkaqet përse dy fshatrat Gjocaj dhe Jasiq kanë vendosur të shpërngulën në qytezën e Junikut duke i lënë fshatrat e tyre.

## **Kuvendi komunal dhe kryetari i komunës**

Komuna e Junikut nuk ka një histori të gjatë të ekzistimit të saj. Kjo komunë së pari filloi të funksionoj si pilot komunë, e mbështetur në Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2005/11. Që nga fillimi, kryetar i kësaj komune ishte emëruar Tahir Isufaj. Pasi që në këtë komunë asnjëherë nuk kishte pas zgjedhje lokale andaj edhe kryetari aktual nuk kishte pas rastin të ofroj para qytetarëve një program qeverisës.

Zgjedhjet lokale në Komunën e Junikut për herë të parë do të mbahen me 15 Nëntor 2009. Partia më e madhe në këtë komunë konsiderohet të jetë LDK-ja, e cila deri më tani ka më së shumti deputet në Kuvendin Komunal. Nga gjithsej 14 ulëse sa ka Kuvendi Komunal i Junikut, deri më tani 8 i kanë takuar deputetëve nga radhët e LDK-së, kurse 6 ulëse u kanë takuar deputetëve nga radhët e AAK-së. Përzgjedhja e përfaqësuesve për Kuvend Komunal është bërë sipas fuqisë së votës nga zgjedhjet e

fundit të 2002 që janë mbajtur në kuadër të komunës së Deçanit dhe përzgjedhja e tyre nga listat zgjedhore.

Edhe pas zgjedhjeve të Nëntorit 2009, KK i Junikut do t'i ketë 15 ulëse. Në të gjithë komunat e Kosovës numri i votuesve ka shkuar gjithnjë dukë rënë në tri palë zgjedhjet e kaluara. Meqë në Komunën e Junikut zgjedhjet mbahen për herë të parë, pritet që pjesëmarrja në zgjedhje të jetë e kënaqshme, së paku kështu na lë të kuptojmë entuziazmi i qytetarëve të kësaj komune për zgjedhjet që po vinë. Qytetarët pritet të dalin në votime ngase ata zgjedhin për here të parë udhëheqësit e komunës së tyre. Në Komunën e Junikut të drejtë vote do të kenë 4,963 qytetarë.

## Buxheti i Komunës

Komuna e Junikut për vitin 2009 kishte një buxhet prej 841,000 euro. Nga kjo shumë, komuna ka realizuar të hyra vetanake në vlerë prej 35,000 euro, kurse 806,103 euro të buxhetit total kanë qenë grant ndërqeveritar. Por, sikurse edhe në çdo komunë tjetër buxheti komunal për vitet e ardhshme pritet të rritet e bashkë me te pritet të rriten edhe investimet kapitale.

## Investimet kapitale

Buxheti komunal i kësaj komune i destinuar për investime kapitale është i ulët. Dy nga projektet më me rëndësi të cilat janë realizuar me buxhetin e kësaj komune i kemi renditur në tabelën më poshtë.

Tab.1.: Investimet kapitale në Junik gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Ndërtimi i ujësjellësit në lagjen Gacaferi	€15,000
2009	Ndërtimi i rrugës lokale te Hybja	€10,000

Kuvendi Komunal i Junikut veç ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Buxheti i përgjithshëm i komunës pritet të rritet nga viti në vit dhe bashkë me të do të rritet edhe shuma për investime kapitale. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Junikut do të ketë në dispozicion 725,981 euro për investime kapitale. Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Junikut për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion afër 1 milion euro për investime kapitale.

Tab.2.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Junikut 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	1,000,978	1,010,224	1,044,325
Të hyrat vetanake në €	43,172	44,524	45,872
Investimet kapitale në €	224,445	233,721	267,802

## Administrata komunale

Në komunën e Junikut të dhënat për vitin 2009 tregojnë se numri i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë është 141. Krahasuar me vitin 2008, numri i shërbyesve civil është rritur për 23 persona. Duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.10/46 (3 dhjetor 2008), e cila thotë se për 620 banorë duhet të ketë një punëtorë administrative, del se komuna e Junikut duhet të ketë 55 punëtorë administrativ. Momentalisht kjo komunë ka 18 punëtorë administrativ, çka do të thotë se ka të drejtë që të rekrutoj staf deri të arrihet shifra prej 55 punonjësish. Numri prej 55 punëtorëve administrativ është parë i nevojshëm në mënyrë që të mund të mbulohen të gjithë sektorët me staf të mjaftueshëm.

Tab.3. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Junikut sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	141 ▲
2008	118
2007	119 ▲
2006	15 ▲

## Komuna e Junikut dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht numrit të mbledhje që duhet t'i mbaj kuvendi komunal gjatë një viti, e që duhet të jetë minimum 10 mbledhje në vit, KK i Junikut gjatë vitit 2008 ka mbajtur gjithsej 10 mbledhje. Kurse gjatë periudhës janar-qershor 2009, KK e Junikut ka mbajtur 6 mbledhje të rregullta, numër ky që është konform nenit 43.2 të ligjit të lartpërmendur. Ndërkaq, Komiteti për Politikë dhe Financa ka funksionuar normalisht, ku gjatë vitit 2008 është takuar gjithsej 9 herë, kurse në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimin strategjik të komunës.

Ndërsa sa i përket tubimeve publike që komuna ka mbajtur me qytetarët, Komuna e Junikut gjatë vitit 2008 ka mbajtur tri debate publike me qytetarë, kurse për gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 është mbajtur një tubim. Sa i përket kërkesave për qasje në dokumente zyrtare komuna e Junikut nuk ka pasur ndonjë kërkesë deri më sot. Komuna gjithashtu nuk ka pranuar asnjë peticion brenda dy viteve të fundit.

Kjo komunë ka edhe uebfaqen e saj zyrtare. Uebfaqes i mungojnë një sërë informacionesh ashtu që një qytetari të Junikut do t'i nevojiteshin rreth aktiviteteve të komunës dhe më gjerë. Pamja vizuale e ballinës është përplot me dizajne multimediale, që duket shumë jo formale.

Tab.4. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Junikut ([www.juniku-komune.org](http://www.juniku-komune.org))

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave <sup>2</sup>
Ballina	3
Organizimi komunal	4.67
Shërbimet komunale	2.6
Info rreth qytetit	3.5
Projektet komunale	1.5
Lajme& lajmërimë	1
Harta e faqes	3
Kontakt	5
Gjuhët	5
Fusha për kërkim	1
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	2
Mesatarja totale	2.86
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	16

## Gjendja në arsim

Komuna e Junikut ende nuk ka çerdhe për fëmijë, përderisa sistemi shkollor zhvillohet në tri nivele, atë parashkollor, fillor dhe të mesëm. Juniku ka tri shkolla gjithsej, dy fillore dhe një të mesme. Në shkollën fillore 'Edmond Hoxha' vijojnë mësimin 1124 nxënës, kurse në shkollën e mesme 'Kuvendi i Junikut' vijojnë mësimin mbi 250 nxënës. Të dy këto objekte shkollore janë ndërtime të reja, dhe si të tilla janë mjaft të përshtatshme për mësim. Megjithatë, këto shkolla ende nuk kanë salla sporti, e kur dihet se komuna nuk ka edhe qendër sportive. Në përgjithësi, numri i personelit arsimor është 66.

## Gjendja në shëndetësi

Shërbimet parësore shëndetësore në këtë komunë janë të organizuara sipas sektorit publik. Komuna e Junikut ka vetëm një Qendër të Mjekësisë Familjare, atë 'Dr. Ali Hoxha', në të cilën kryejnë shërbimet rreth 10,000 banorët e kësaj komune. Aty ekziston edhe shërbimi i stomatologjisë dhe laboratorit biokimik. Qytetarët ankohen për mungesë të barnave.

## Shoqëria civile

Shoqëria civile në Komunën e Junikut nuk është e organizuar dhe si e tillë nuk është edhe shumë aktive. Ndoshta një gjendje e tillë ndodh për shkak se kjo është një komunë e re dhe se deri më tani nuk ka pasur kapacitete të zhvillohet ky sektor me rëndësi për shoqërinë.

<sup>2</sup> (rradhitja nga 1 deri 5) 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

## Mediat lokale

Komuna e Junikut nuk ka ndonjë radio apo televizion lokal e as edhe ndonjë korrespondent të gazetave të përditshme kosovare. Prandaj, qytetarët e Junikut kryesisht informohen nga televizionet apo radiot publik dhe ato private të komunave për rreth.

## Rendi dhe ligji në Komunën e Junikut

Në përgjithësi komuna e Junikut konsiderohet si komunë e qetë ku respektohet rendi dhe ligji. Kjo mbase është edhe si pasojë e numrit jo edhe aq të madh të banorëve në këtë komunë. Edhe pse nuk ka stacion policor, në këtë komunë shpesh patrollojnë pjesëtar të Policisë së Kosovës dhe deri vonë kjo komunë ka qenë e frekuentuar mjaft edhe nga pjesëtarë e KFOR-it. Në mungesë të një stacioni policor, nuk është e mundur nxjerrja e rasteve për shkeljen e rendit dhe ligjit në këtë komunë, ngase Juniku nuk figuron si njësi e veçantë në kuadër të statistikave të Policisë së Kosovës. Kjo komunë ka edhe shërbimin e zjarrfikësit, edhe pse rastet për intervenim kanë qenë të rralla.

## Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Tab.5. Tatimi në pronë në Komunën e Junikut

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.10%	0.10%	0.20%	0.15%	0.05%
I	350	350	500	250	150
II	270	270	400	200	100
III	200	200	300	150	50
IV	150	150	200	100	20

\* Vlera e tregut për metër katror.

## Kostoja për biznese

Tabela më poshtë pasqyron disa nga bizneset më të zakonshme në komunën e Junikut si dhe shumën e taksave vjetore që duhet paguar për secilin biznes:

Tab.6. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	250 €
Kompanitë e sigurimit	250 €



KEK	250 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	250 €
Prodhuesit e energjisë elektrike	400 €
Agjensionet turistike	150 €
Hotelet	250 €
Motelet	200 €
Supermarketet-Hipermarketet	200 €
Vetëshërbimet – Minimarketet	80 €
Kafeteritë	100 €
Restorant	150 €
Telekomunikimit	100 - 150€
Barnatoret	50 €
Autoshkollat	150 €
Punëtoritë (argjendaritë, zdukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktarët, etj.)	50 -140 €
Depot ndërtimore	200 €
Pompat e benzinës	200 €
Ndërmarrjet ndërtimore	200 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	80 – 150 €

## Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shtator-tetor, 2009.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2009. (<http://mef-rks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2010-2012 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale deri më 30 shtator 2009.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2007 “Jeta në Kosovë”, [www.jetanekosove.com](http://www.jetanekosove.com).
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2004.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2008.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2008. Janar, 2009.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2009. Shtator, 2009.
12. Policia e Kosovës. Statistika në lidhje me raste të ndryshme kriminale dhe aksidente të komunikacionit. 24 gusht 2009.
13. Komisioni Qendror Zgjedhor. Zgjedhjet komunale 2000, 2002 dhe 2007. Si dhe listat e votuesve me të drejtë vote për zgjedhjet e 2009.
14. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndihmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2009.
15. Ministria e Shërbimeve Publike. Të dhënat e të punësuarve në administratë në komuna. Mars, 2008.